

SKEMA E GRANTEVE PËR PËRFAQËSIM RAJONAL/NDËRKOMBËTAR TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

UDHËZUES PËR APLIKIM

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), me qëllim të fuqizimit të rolit të shoqërisë civile në hartim dhe zbatim të politikave, të cilat prekin komunitetin dhe publikun e gjerë përmes nxitjes së veprimeve të përbashkëta me partnerët, ofron përkrahje financiare për përfaqësim rajonal/ndërkombëtar të organizatave të këtij sektori.

KUSH MUND TË APLIKOJË: Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të regjistruara në Kosovë.

KRITERET E PËRZGJEDHJES:

Të gjitha aplikimet do të shqyrtohen individualisht dhe do të vlerësohen nga komisioni, bazuar në këto kriteret:

- Prezantimi i punës së organizatës para një audience rajonale/ndërkombëtare;
- Prezantimi ose avokimi për çështje të caktuara me interes për organizatën apo vendin në forume rajonale/ndërkombëtare;
- Krijimi i mundësive për rrjetëzim, sigurim të fondeve apo bashkëpunime strategjike me organizata dhe donatorë të tjerë rajonalë/ndërkombëtarë;
- Prezantimi i përvojave dhe praktikave të funksionimit të organizatës apo trajtimit të çështjeve me interes për vendin apo organizatën.

CILAT AKTIVITETE PËRKRAHEN?

Përfaqësimi në kongrese, konferenca, seminare, punëtori, takime strategjike, takime të ndryshme të rrjeteve (kuvendet e anëtarëve, bordet, komisionet) etj. Përparësi do të kenë aplikuesit që kanë rol aktiv gjatë pjesëmarrjes dhe do të ofrojnë kontribut të drejtpërdrejtë në aktivitetet. Aktiviteti duhet të jetë i ndërlidhur me punën e organizatës (misionin/fushat e veprimit) të cilën e përfaqëson.

CILAT SHPENZIME PRANOHEN: shpenzimet e transportit, akomodimit, shpenzimet e regjistrimit për ngjarje, transporti lokal dhe shpenzimet e vizës.

Nuk bëhet rimbursim i pagesave të realizuara para aprovimit të kërkesës për grant.

Përparësi do të kenë aplikantët, të cilët mbulojnë ndonjë pjesë të shpenzimeve nga burime të tjera.

Aplikantët mund të jenë përfitues të grantit **një herë brenda vitit**.

Në parim do të financohet vetëm një përfaqësues nga një organizatë, por në rast të arsyeshmërisë së fuqishme të nevojës së udhëtimit të dy personave, mund të konsiderohet edhe ky opsion.

Përkrahur nga:



Procesi i financimit të granteve për përfaqësim ka dy faza:

1. APLIKIMI

- Aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentet në vijim:
 - o Formën e aplikimit (shkarkohet nga www.kcsfoundation.org);
 - o Një kopje të certifikatës së regjistrimit të OJQ-së të lëshuar nga MAP.
 - o Konfirmimin nga punëdhënësi (autorizim për pjesëmarrje në emër të organizatës) duke specifikuar pozitën dhe rolin në organizatë.
 - o Ftesën dhe agjendën e aktivitetit/ngjarjes.
 - o Çfarëdo dokumenti që dëshmon mbulimin e ndonjë shpenzimi nga organizatorët, organizata, apo palë të treta (nëse aplikohet).
- Aplikacioni i kompletuar duhet të dërgohet në formë elektronike në e-mailin kcsfsida@kcsfoundation.org me titull në subjekt të e-mailit **“Aplikacion për grant për përfaqësim- Emri i plotë i aplikantit” së paku 15 ditë para mbajtjes së aktivitetit/ngjarjes**. Ju lutem ta keni parasysh edhe kohën e paraparë për aplikim për vizë.
- Në e-mail duhet të jenë të bashkëngjitura të gjitha dokumentet për aplikim. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të vlerësohen.
- Aktivitetet duhet të realizohen gjatë vitit 2017. KCSF-ja do të njoftojë aplikuesin/en për vendimin më së voni 10 ditë pas konfirmimit për pranim të aplikacionit.
- Aplikuesi/sja, i cili do të përkrahet për financim, do të nënshkruajë kontratë me KCSF-në.
- Shuma maksimale e përkrahjes: **1,000 euro**
 - o **Transporti (aeroplan, autobus, tren, veturë). Udhëtimi vetëm në klasë ekonomike.**
 - o **Shpenzimet e regjistrimit.**
 - o **Akomodimi.**
 - o **Transporti lokal.**
 - o **Viza – maksimum 150 euro.**
- Aplikimi për grante individuale do të jetë i hapur deri në shpenzim të fondeve. Fondi në dispozicion për vitin 2017 është 15,000 euro.
- Përzgjedhja do të bëhet në bazë të kriterëve, përparësi do të kenë ata që aplikojnë të parët.

2. RIMBURSIMI

- Aplikuesit/sve të suksesshëm do t’u transferohet 50% e shumës totale të përkrahjes pas nënshkrimit të kontratës me KCSF-në. Në rastet kur nevojitet pajisje me vizë, transferimi i mjeteve do të bëhet pas dorëzimit të dëshmisë së pajisjes me vizë (kopja e vizës). Pjesa tjetër paguhet pas kthimit.
- Për rimbursim përfituesi duhet t’i dërgojë këto dokumente: **1)** formën për rimbursim (shkarkohet në www.kcsfoundation.org), **2)** dëshmitë për të gjitha shpenzimet e bëra për të cilat kërkohet rimbursim (fatura, bileta, boarding pass, etj) dhe **3)** raportin i cili duhet të përmbajë informata të përmbledhura rreth aktivitetit të vijuar.

Përkrahur nga:



- Të gjitha dokumentet origjinale duhet të dorëzohen në adresën “Fazli Greiçevci”, 55, 10000 Prishtinë, **jo më vonë se 10 ditë pune** pas kthimit nga udhëtimi.
- Rimbursimi do të realizohet më së voni 10 ditë pune nga konfirmimi i rregullsisë së dokumenteve (pranimi i shpenzimeve). Shuma që do të rimbursohet do të transferohet në llogarinë bankare të aplikuesit të paraqitur në formë.
- Raportet e paplotësuara apo ato të cilat nuk e respektojnë afatin kohor për dorëzim të dokumenteve do të humbin mundësinë e rimbursimit, si dhe aplikuesi detyrohet t’i kthejë mjetet e marra avancë.

Të gjitha pyetjet lidhur me aplikimin për grante nga kjo skemë mund të dërgohen në e-mailin kcsfsida@kcsfoundation.org

Përkrahur nga:

